



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

*VENDIM*

**Nr. 167, Datë 19.07.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DERBI-E” SH.P.K,  
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA HEC “ANTENA” ME  
FUQI TE INSTALUAR 1105 KW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” i ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10, pika 3, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “*Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena” me fuqi të instaluar 1105 kW,

**Konstatoi se:**

Shoqëria “DERBI -E”shpk me shkresën nr. 69 prot, datë 11.07.2018, protokolluar në ERE me nr. 503 prot, datë 11.07.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me fuqi te istaluar 1105 kW, për një periudhë 49 vjeçare.

Aplikimi i shoqërisë “DERBI-E” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; 4.1.5 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DERBI-E“ sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena” me fuqi të instaluar 1105 KW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.